



Nr. Ref: 05/2025
Data: 27 Prill 2025

Drejtuar:

- Sh.S.Znj. Vjosa Osmani, Presidente e Republikës së Kosovës
- Kuvendi i Republikës së Kosovës

Lënda:

Propozim për ndërmarrje të veprimeve urgjente lidhur me moskonstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës

**E nderuara Presidente Osmani,
Të nderuar Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

Instituti për Leadership Civil, duke ndjekur me shqetësim situatën e krijuar pas zgjedhjeve të parakohshme të 9 shkurtit 2025, dhe duke vlerësuar rëndësinë jetike të funksionimit të rregullt institucional, në përputhje me parimet dhe normat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ju drejtohet me këtë shkresë, për të propozuar:

1. Thirrjen dhe zhvillimin urgjent të konsultimeve ndër-partiake nën ndërmjetësimin e Presidentes së Republikës, me qëllim të lehtësimit të një marrëveshjeje për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe të Kryesisë.
2. Respektimin strikt të afateve kushtetuese për konstituimin e Kuvendit, në përputhje me nenin 67 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që përcakton se Kuvendi duhet të mbledhet dhe konstituohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve.
3. Në rast të dështimit të përsëritur për konstituim, kërkimin nga Presidentja të një interpretimi zyrtar nga Gjykata Kushtetuese, për të përcaktuar qartë pasojat e moskonstituimit dhe hapat e mundshëm për shpërndarjen e Kuvendit dhe thirrjen e zgjedhjeve të reja, në përputhje me nenin 82 të Kushtetutës.
4. **Thirrje për përgjegjësi politike të lartë:** Instituti fton të gjitha subjektet politike të demonstrojnë pjekuri politike, të tejkalojnë interesat partiake afatshkurtra dhe të



INSTITUTI PËR LIDERSHIP CIVIL (ILC/ICL)

Rr. "Behar Begolli", Prishtinë

Email: info@ilc-rks.org leadershipcivil@gmail.com

www.ilc-rks.org

Tel: +383 (0) 44 ose 49 - 55 52 62

kontribuojnë në funksionalizimin e Kuvendit si institucion themelor i demokracisë parlamentare në vend.

Përfundimisht, në respekt të Kushtetutës dhe të vullnetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës, është imperative që të ndërmerren veprime të shpejta dhe të koordinuara për të siguruar konstituimin e institucioneve të reja, garantimin e stabilitetit politik dhe ruajtjen e rendit demokratik.

Instituti për Lidership Civil
